REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Bilisht me,_____/_____/2026

PROJEKT-VENDIM

NR. 77, DATË 30/09/2026

''PER DHËNIEN E MENDIMIT ZYRTAR MBI PROJEKTLIGJIN "PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 108, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,të neneve , 10, 12, 55, pika 6, nenit 64, shkronja "c", dhe 86 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; në vijim të shkresës nr 3573 prot., datë 31.07.2026 , të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me të cilën është përcjellë për dhënie mendimi projektligji "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"; Bashkia Devoll

Propozon:

1.Të japë mendim zyrtar pozitiv për propozimin e projektligjit "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit Bashkia Devoll vijon si njësi më vete e qeverisjes vendore, me qendër qytetin e Bilishtit dhe me organizimin administrativo-territorial të përcaktuar në projektligj.

2. Të vlerësoje se vijimesia e Bashkisë Devoll si njësi më vete e qeverisjes vendore është në përputhje me karakteristikat territoriale, administrative, funksionale, ekonomike, sociale dhe historike të saj, lidhjet tradicionale dhe komunitare,pozicionin kufitar,organizimin institucional dhe administrativ të konsoliduar ndër vite, si dhe nevojën për ruajtjen e afërsisë së qeverisjes dhe të shërbimeve vendore me qytetarët, sipas argumentimit të paraqitur në relacionin shpjegues bashkëlidhur këtij projektvendimi.

3. Mendimi zyrtar i Këshillit Bashkiak Devoll, i shprehur me këtë vendim, t'i përcillet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në përgjigje të kërkesës së përcjellë me shkresën nr 3573 prot., datë 31.07.2026 dhe në kuadër të procesit të shqyrtimit të projektligjit.

4. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë Devoll dhe kryetari i Këshillit Bashkiak Devoll, , për zbatimin e këtij vendimi dhe përcjelljen e mendimit zyrtar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes, në përputhje me nenin 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Konceptoi: O. Zhuleku
Konfirmoi bazueshmërinë ligjore: E. Avdo
Pranoi: A. Rushitaj

KRYETARI BASHKISË

EDUARD DURO

Adresa:Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; web: http://bashkiadevoll.gov.al/
info@bashkiadevoll.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3806 **Prot** **Bilisht me,** 30 / 09 /**2026**

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN

"PËR DHËNIEN E MENDIMIT ZYRTAR MBI PROJEKTLIGJIN 'PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË'

Të nderuar këshilltarë,

Në kuadër të procesit të shqyrtimit të projektligjit "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" dhe në vijim **të shkresës** nr 3573 prot., datë 31.07.2026, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me të cilën projektligji është përcjellë për dhënie mendimi, ju paraqitet për shqyrtim projektvendimi për shprehjen e mendimit zyrtar të Këshillit Bashkiak Devoll.

Projektligji propozon një organizim të ri administrativo-territorial të vendit me **46 bashki dhe 12 qarqe**. Në këtë organizim të propozuar, **Bashkia Devoll vijon si njësi më vete e qeverisjes vendore**, pa u bashkuar me një bashki tjetër, pa ndryshim të kufijve të saj territorialë dhe pa ndryshim të qendrës së Bashkisë.

Për Bashkinë Devoll ruhet qendra e Bashkisë në Bilisht dhe organizimi me njësitë administrative **Bilisht, Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras**, së bashku me qytetin dhe fshatrat përbërës të tyre.

Nëpërmjet këtij relacioni paraqiten baza ligjore, parashikimi konkret i projektligjit për Bashkinë Devoll dhe argumentet kryesore territoriale, administrative, funksionale, ekonomike, sociale dhe historike që mbështesin mendimin e propozuar.

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT

Qëllimi i projektvendimit është që Këshilli Bashkiak Devoll, si organi përfaqësues i bashkisë, të shprehë mendimin e tij zyrtar mbi projektligjin e përcjellë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe, në mënyrë të veçantë, mbi parashikimin që lidhet me Bashkinë Devoll.

Sipas projektligjit, Bashkia Devoll vijon të parashikohet si njësi më vete e qeverisjes vendore, me qendër Bashkie Bilishtin dhe me organizimin administrativo-territorial të përcaktuar në projektligj.

Për këtë arsye, projektvendimi që paraqitet për shqyrtim propozon **dhënien e mendimit zyrtar pozitiv për këtë parashikim të projektligjit**, duke vlerësuar se vijimësia e Bashkisë Devoll si njësi më vete është në përputhje me karakteristikat e territorit, lidhjet e komunitetit, funksionalitetin e organizimit vendor dhe nevojën për ofrimin e shërbimeve sa më pranë qytetarëve.

II. BAZA LIGJORE

Projektvendimi mbështetet në **nenin 108, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, sipas të cilit ndarjet administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj, mbi bazën e nevojave dhe interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike.

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, përcakton kuadrin ligjor të organizimit dhe funksionimit të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe marrëdhëniet e tyre me qeverisjen qendrore.

Në mënyrë të veçantë:

-neni 10 përcakton se marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore bazohen në parimet e subsidiaritetit, konsultimit dhe bashkëpunimit;

-neni 12 parashikon konsultimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për politikat, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre;

-neni 64, shkronja "c", përcakton kompetencën e Kryetarit të Bashkisë për marrjen e masave për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, përfshirë edhe çështjet që kërkon t'i paraqesë vetë Këshillit;

-neni 86 përcakton se riorganizimi administrativo-territorial realizohet duke marrë në konsideratë interesat ekonomikë dhe socialë, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore, me synim realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore ose zbatimin e politikave të zhvillimit vendor dhe rajonal.

Gjithashtu, ligji nr. 139/2015 përcakton si mision të vetëqeverisjes vendore sigurimin e një qeverisjeje të efektshme dhe efikase, në një nivel sa më afër qytetarëve, duke njohur identitetet dhe vlerat e bashkësive dhe duke siguruar ushtrimin efektiv të funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me nevojat e komunitetit.

Në zbatim të këtij kuadri kushtetues dhe ligjor, si dhe në vijim të kërkesës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e mendimit mbi projektligjin, **Kryetari i Bashkisë Devoll paraqet për shqyrtim këtë projektvendim.**

III. PARASHIKIMI I PROJEKTLIGJIT PËR BASHKINË DEVOLL

Projektligji i përcjellë për mendim propozon një organizim të ri administrativo-territorial të Republikës së Shqipërisë me **46 bashki dhe 12 qarqe**.

Në këtë organizim të propozuar, **për Bashkinë Devoll nuk parashikohet bashkim me një bashki tjetër, ndryshim i kufijve territorialë apo ndryshim i qendrës së Bashkisë por ajo vijon të parashikohet si njesi më vete e qeverisjes vendore.**

Në tabelën për Qarkun Korçë, projektligji parashikon **Bashkinë Devoll, me qendër Bashkie Bilishtin, qytetin Bilisht dhe njësitë administrative Bilisht, Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras, së bashku me fshatrat përbërës të tyre.**

Për rrjedhojë, projektligji ruan vijimësinë e Bashkisë Devoll si njësi më vete e qeverisjes vendore, qendrën e saj në Bilisht dhe organizimin administrativo-territorial të territorit të saj.

IV. VLERËSIMI PËR BASHKINË DEVOLL

Parashikimi i projektligjit për vijimësinë e Bashkisë Devoll si njësi më vete vlerësohet pozitivisht, duke marrë në konsideratë tërësinë e karakteristikave territoriale, administrative, funksionale, ekonomike, sociale dhe historike të saj.

Së pari, Bashkia Devoll përbën një territor me lidhje të konsoliduara historike, tradicionale, ekonomike dhe sociale.

Qyteti i Bilishtit, njësitë administrative dhe fshatrat përbërës formojnë një hapësirë territoriale dhe komunitare me lidhje të krijuara dhe të zhvilluara ndër vite. Këto lidhje përbëjnë një element të rëndësishëm të vazhdimësisë së territorit dhe të marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve që e përbëjnë atë.

Së dyti, Bashkia Devoll karakterizohet nga një territor me shtrirje të konsiderueshme rurale dhe me vendbanime të shpërndara.

Largësitë ndërmjet fshatrave, qendrave të njësive administrative dhe qendrës së Bashkisë ndikojnë drejtpërdrejt në aksesin e qytetarëve në administratë dhe në shërbimet vendore.

Në këtë kuptim, ruajtja e një organizimi vendor që garanton afërsinë e administratës dhe të shërbimeve me komunitetin merr rëndësi të veçantë, veçanërisht për banorët e zonave rurale dhe të vendbanimeve më të largëta nga qendra e Bashkisë.

Së treti, Bashkia Devoll ka një pozicion të veçantë kufitar.

Pozicioni i saj në kufirin shtetëror me Republikën e Greqisë përbën një karakteristikë të rëndësishme gjeografike, ekonomike dhe sociale të territorit. Ky pozicion lidhet me lëvizjen, aktivitetin ekonomik, zhvillimin e zonës dhe me nevoja specifike të administrimit të një territori kufitar.

Për këtë arsye, pozicioni gjeografik i Devollit përbën një element që duhet vlerësuar së bashku me karakteristikat e tjera territoriale dhe funksionale të Bashkisë.

Së katërti, Bashkia Devoll ka ndërtuar dhe konsoliduar ndër vite një organizim institucional, administrativ dhe funksional të përshtatur me shtrirjen territoriale dhe nevojat e komunitetit.

Administrata qendrore e Bashkisë, njësitë administrative dhe strukturat ne varesi te saj për ushtrimin e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve janë organizuar për administrimin e territorit në konfigurimin e tij aktual.

Gjatë viteve është krijuar një vazhdimësi në organizimin e administratës, në ndarjen e përgjegjësive, në marrëdhënien funksionale ndërmjet qendrës së Bashkisë dhe njësive administrative, si dhe në mekanizmat nëpërmjet të cilëve ushtrohen funksionet dhe ofrohen shërbimet për qytetarët.

Në këtë kuptim, nuk bëhet fjalë vetëm për ruajtjen e një kufiri administrativ, por edhe për **vijimësinë e një organizimi institucional dhe funksional të konsoliduar ndër vite**, të ndërtuar për administrimin e këtij territori dhe për nevojat e komuniteteve që e përbëjnë atë.

Ruajtja e Bashkisë Devoll si njësi më vete mundëson vijimësinë e këtij organizimi, të marrëdhënieve të krijuara ndërmjet qendrës së Bashkisë , njësive administrative,dhe Agjensie se sherbimeve publike ne varesi te saj si dhe të proceseve te tjera të ngritura për ushtrimin e funksioneve vendore.

Së pesti, Devolli përfaqëson një bashkësi me identitet dhe lidhje tradicionale të konsoliduara.

Territori, emri, historia dhe lidhjet ndërmjet komuniteteve përbërëse janë pjesë e një vazhdimësie të formuar ndër vite. Bashkia nuk përfaqëson vetëm një ndarje administrative, por edhe hapësirën institucionale në të cilën komuniteti identifikon dhe ushtron vetëqeverisjen e tij vendore.

Ky element nuk vlerësohet i shkëputur nga kriteret e tjera, por së bashku me lidhjet ekonomike e sociale, karakteristikat territoriale dhe funksionalitetin e organizimit vendor. Ai është në përputhje me parimet ligjore që kërkojnë marrjen në konsideratë të traditës, kulturës, lidhjeve tradicionale dhe vlerave të tjera vendore.

Së gjashti, vijimësia e Bashkisë Devoll si njësi më vete ruan afërsinë e qeverisjes vendore me qytetarin.

Një nga parimet themelore të vetëqeverisjes vendore është ushtrimi i funksioneve dhe kompetencave në një nivel sa më pranë komunitetit, duke marrë në konsideratë natyrën e detyrave, nevojat e qytetarëve, eficiencën dhe ekonominë e shërbimit.